

**AKTI I THEMELIMIT DHE STATUTI**  
**I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR**  
**“ Arknet” SHPK.**

Sot, me date 12 Janar 2022 :

**ORTAKET/THEMELUESIT**

**Renalto Murati**, i biri Myfit , i datëlindjes 23 Qershor , lindur në 1979, banues në Tiranë,Rr Qemal Stafa, P. 11, Sh.2, Ap 19, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtës i letërnjoftimit ne Nr. 035625577.

**Sokol Alikaj**, i biri Siri, i datëlindjes 30 Gusht , lindur në 1980, banues në Tiranë,Rruga” Mihal Grameno” Pll.109 shk.1/10, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtës i letërnjoftimit ne Nr. 034019870

*Te cilet, konform ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar, shpreh vullnetin e lirë e të plotë, për të krijuar një shoqëri tregtare, të formës shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e cila do të krijohet dhe veprojë sipas legjislacionit në fuqi për shoqëritë tregtare.*

**KREU 1**  
**THEMELIMI , EMRI, OBJEKTI, KOHEZGJATJA, SELIA**

**NENI. 1**  
**DATA E THEMELIMIT, EMRI DHE THEMELUESIT**

1. Sot ne daten e nenshkrimit u themelua shoqeria me pergjegjesi te kufizuar me emrin “Arknet” shpk.


2. Themeluesit e shoqerise jane:

- Renalto Murati**, i biri Myfit , i datëlindjes 23 Qershor , lindur në 1979, banues në Tiranë,Rr Qemal Stafa, P. 11, Sh.2, Ap 19,Tiranë, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtës i letërnjoftimit ne Nr. 035625577 me nr personal H90623064Q
- **Sokol Alikaj**, i biri Siri, i datëlindjes 30 Gusht , lindur në 1980, banues në Tiranë,Rruga” Mihal Grameno” Pll.109 shk.1/10, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtës i letërnjoftimit ne Nr. 034019870 me nr personal I00830050K

**NENI. 2**  
**OBJEKTI I SHOQERISE**

2.1 *Objekt i kesaj shoqerie do te jete:*

- Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar do të zhvillojë aktivitet me objektin e mëposhtëm:



- Projektimi dhe infrastruktura e rrjeteve te perdorura ne funksionimin e rrjeteve publike dhe private te tilla si rrjetet e telekomunikacionit te cdo lloj, rrjetet e ujit, tubacionet e gazit, rrjetet e energjise elektrike; futur dhe bazat e te dhenave perditesisim ne emer te operatoreve qe kryejne sherbim dhe per palet e treta. Konsulence ne fushen e informatikes, menaxhim i sistemeve informatike, pjesemarrje ne gara publike persa ne kete pike. Shit-blerja dhe instalimi dhe asistenca e produkteve hardware dhe software. Zhvillimi i studimeve dhe kerkimeve ne fushen e informatikes, organizimi dhe menaxhimi i sherbimeve te lidhura. Prodhimi dhe tregtimi i softuereve aplikative dhe bazike, konsulence ne fushen e informatikes, sherbime per palet e treta per veprimtarite qe lidhen me produktet e permendura ne piken A) Konsulence biznesi ne lidhje cfare percaktohet ne kete nen; B) Sigurimi i akseseve dhe sherbimeve ne rrjetet telematike; C) Ofrimi i sherbimeve per bizneset, individet, shoqerite dhe organizatat, duke perfshire por pa u kufizuar ne: ofrimin e sherbimeve ne sektoret grafike, reklamim, botim, IT dhe telekomunikacion; D) Sigurimi i sherbimeve te telekomunikimit edhe permes perdorimit te kompjutereve qendrore dhe pajisjeve te rrjetit; E) Ushtrimi i çdo aktiviteti te lidhur me sherbimet qe lidhen me internetin dhe rrjetet kompjuterike, sic eshte hartimi, zbatimi, mirembajtja e faqeve ne internet dhe platformave te tregtise elektronike dhe aplikacioneve mobile. F) Promovimi i te gjitha veprimtarive te domosdoshme dhe te nevojshme per arritjen dhe permbushjen e plote te qellimeve te shoqerise; G) Ndhime teknike per mallrat dhe sherbimet qe perfshihen ne objektin e aktivitetit dhe mbeshtetje operacionale ne lidhje me perdorimin e sherbimeve te ofruara; H) Organizimi dhe administrimi i kurseve te trajnimit dhe kualifikimit profesional per produktet dhe sistemet e permendura me lart dhe per aktivitetet qe lidhen me perdorimin e tyre. Sigurimi i sherbimeve per transferimin e teknologjise ne sektorin e IT- se dhe ndermjetesimi i informacionit ndermjet bankave te ndryshme te te dhenave (perfshire te vetat) dhe subjekteve perdoruese

2.2 Per te gjitha aktivitetet qe kerkojne licenca te vecanta shoqeria do te angazhohet qe tani per te plotesuar kerkesat e ligjeve te posacme.

### **NENI. 3 KOHEZGJATJA**


3.1 Kohezgjatja e shoqerise do te jete me afat te pacaktuar e aktiviteti i shoqerise mund te mbyllet sipas vendimit te Asamblese se ortakëve.

### **NENI. 4 SELIA E SHOQERISE**

- 4.1 Shoqëria e ka selinë në adresën Rruga Rruga” Mihal Grameno” Pll.109 shk.1/10 ,Tirane, Shqipëri.
- 4.2 Shoqeria mund te hape edhe zyra perfaqesie, dege, te krijojë filiale dhe/ose te realizojë çdo lloj pjesemarrje ne shoqeri te tjera, siç parashikohet nga ligji, si brenda ashtu edhe jashte Republikes se Shqiperise, sipas vendimit te Asamblese se Ortakëve te marre me shumice te thjeshte votash.

### **KREU II KAPITALI NENI. 5 KAPITALI I REGJISTRUAR**

- 5.1 Kapitali themeltar fillestar i Shoqerise me përgjegjësi të kufizuara është 10.000 (dhjetemije) Leke.
- 5.2 Ai mund të rritet me vendim të ortakëve sipas normave të fushës në fuqi.



Fq. 2

5.3 Pjesëmarrja e themeluesit në kapitalin e shoqërisë është në përputhje me kontributin si vijon:

1. Ortaku Themelues Renalto Murati - zoteron 1 (një) kuote me vlerë të përgjithshme 5.000 Leke (pesemije) që përbën 50 % të kapitalit themeltar të shoqërisë.
2. Ortaku Themelues Sokol Alikaj - zoteron 1 (një) kuote me vlerë të përgjithshme 5.000 Leke (pesemije) që përbën 50% të kapitalit themeltar të shoqërisë


#### NENI. 6 ZMADHIMI DHE ZVOGELIMI I KAPITALIT

- 6.1 Kapitali i shoqërisë mund të zmadhohet nepermjet nenshkrimeve të pjeseve të kapitalit të regjistruar për kontribute në para dhe me anë të kontributeve në natyrë, nepermjet emerimit nga gjykata kompetente e një eksperti të autorizuar për këto kontribute.
- 6.2 Në asnjë rast shumica nuk mund të detyrojë një ortak për të rritur angazhimin e tij në kapitalin të regjistruar të shoqërisë.
- 6.3 Zvogelimi i kapitalit lejohet nga asamblëja e ortakeve, e cila merr vendim në të njëjtat kushte që kërkohej për ndryshimin e statutit.

#### NENI. 7 TRANSFERIMI I KAPITALIT

- 7.1 Kuotat e kapitalit të shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo të kalohen si më poshtë:
  - a) Kontributit në kapitalin e shoqërisë
  - b) Shitblerjes
  - c) Trashëgimise
  - d) Dhurimit
  - e) Cdo mënyrë tjetër përcaktuar në ligj.
- 7.2 Pjesët e kapitalit janë lirisht të transferueshme në çdo moment sipas kushteve të parashikuara nga ligji shqiptar, me kufizimet e përcaktuara në pikat 7.3 dhe 7.4 më poshtë.
- 7.3 Në rast se njëri nga ortakët kërkon të shesë një pjesë ose të gjitha kuotat që ai zoteron në shoqëri, ai është i detyruar që t'ia ofrojë paraprakisht këto kuota ortakut tjetër të shoqërisë, ose vetë shoqërisë me të njëjtin çmim që ai ka vendosur t'ia shesë ato. Kjo ofertë do të quhet e marre nga ortakët tjetër dhe/ose nga shoqëria, në momentin e depozitimit të saj në selinë e shoqërisë.
- 7.4 Në rast se ortakët tjetër të shoqërisë, ose shoqëria, brenda 1 muaji nga data e depozitimit të ofertës nuk përgjigjen për këto oferta, ose refuzojnë ofertën, ortakët ofertues kanë të drejtë t'ia shesë kuotat e tij paleve të treta lirisht menjëherë të provoje që ortakët tjetër nuk kanë përfituar nga drejta e parablerjes.
- 7.5 Përgjegjësia e ortakeve për humbjet e Shoqërisë shtrihet deri në vlerën e kontributit të tyre në kapitalin e Shoqërisë

#### KREU III ORGANET VENDIMARRESE DHE DREJTUESE NENI. 8 ORGANET VENDIMARRESE



Fq. 3

- 8.1 Asambleja e Ortakeve eshte organi i vetem vendimmares i shoqerise.
- 8.2 **Asambleja e pergjithshme eshte kompetente per marrjen e vendimeve per shoqerine per ceshtjet si me poshte:**
- a) Percaktimi i politikave tregetare te shoqerise
  - b) Ndryshimet e statutit
  - c) Emerimin dhe shkarkimin e administratoreve
  - d) Emerimin dhe shkarkimin e likujdatoreve dhe eksperteve kontabel te autorizuar
  - e) percaktimi i shperblimeve per personat e permendur ne shkronjat c) e d)
  - f) Mbikqyrja e zbatimit te politikave tregetare nga administratoret perfshire pergatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise
  - g) Miratimi i bilanceve
  - h) Zmadhim dhe zvogelim kapitali
  - i) Pjestimin e kuotave dhe anulimin e tyre
  - j) Perfaqesimin ne gjykate dhe ne procedimet e tjera ndaj administratoreve
  - k) Riorganizimi dhe prishja e shoqerise
  - l) Miraton rregulla proceduriale te mbledhjeve te asamblese
  - m) Ceshtje te tjera te parashikuara nga ligji.
- 8.3 Ortaku mund te perfaqesohet ne asamblene e pergjithshme, ne baze te nje autorizimi nga nje ortak tjetër apo nga nje person i trete. Administratori i shoqerise nuk mund te veproje si perfaqesues i ortakeve ne asamblene e pergjithshme. Autorizimi mund te jepet vetem per nje mbledhje, e cila perfshin edhe mbledhjet vijuese me te njejtin rend dite.

#### NENI 9

### THIRRJA E MBLEDHJES SE ASAMBLESE SE PERGJITHSHME

- 9.1 Asambleja e pergjithshme thirret nepermjet nje njoftimi me shkrese ose me njoftim nepermjet postes elektronike ne adresat e deklaruar te ortakeve. Njoftimi duhet te permbaje vendin, daten, oren e mbledhjes dhe rendin e dites e t'u dergohet te gjithe ortakeve ne adresat e deklaruar ne shoqeri, jo me vone se 7 dite perpara dates se parashikuar per mbledhjen e asamblese.
- 9.2 Kur asambleja e pergjithshme nuk eshte thirrur sipas pikes 1 te ketij neni, ajo mund te marre vendime te vlefshme vetem nese te gjithe ortakët jane dakort, per te marre vendime, pavaresisht parregullsisë.

#### NENI 10

### MARRJA E VENDIMEVE DHE KUORUMI

- 10.1 Ne rastin e marrjes se cdo vendimi, Asambleja e pergjithshme mund te marre vendim te vlefshem ne cdo rast vetem, nese ortakët qe zoterojne me shume se gjysmen e numrit total te kapitalit, jane te pranishem personalisht, votojne me shkrese, apo mjete elektronike, sipas parashikimeve te pikes 3 te nenit 88 te ligjit te posacem.
- 10.2 Nese kuorumi te permendur ne paragrafin e mesiperem nuk arrihet, asambleja e pergjithshme, mblidhet perseri jo me vone se 30 dite, me te njejtin rend dite.
- 10.3 Asambleja e pergjithshme vendos me  $\frac{3}{4}$  e votave te zoteruesve te kapitalit te ortakeve pjesmarres, per ndryshimin e statusit, zmadhimin ose zvoglimin e kapitalit te regjistruar, shperndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqerise.
- 10.4 Asambleja e pergjithshme vendos me shumicen e votave te ortakeve pjesemarres, per ceshtjen te tjera.

- 10.5 Cdo ndryshim statuti duhet te depozitohet prane QKB per te pasqyruar ndryshimet ne regjistrin e shoqerise.

## NENI 11 PERJASHTIMI NGA E DREJTA E VOTES

- 11.1 Ortaku nuk mund te ushtroje te drejten e votes nese asambleja e pergjithshme merr vendimin per:
- a) vleresimin e veprimtarise se tij
  - b) shuarjen e ndonje detyrimi ne ngarkim te tij
  - c) ngritjen e nje padije ndaj tij nga shoqeria
- 11.2 Kur ortaku perfaqsohet nga nje perfaqesues i autorizuar, i autorizuari vleresohet te jete ne te njejtin konflikt interesi, ashtu si dhe ortaku, te cilin perfaqeson.

## NENI 12 ADMINISTRIMI

- 12.1 Asambleja e pergjithshme emerom me shumice te thjeshte te votave te zoteruesve te kalitalit nje ose me shume persona fizike si administratore te shoqerise. Afati i emerimit, eshte 5 vjet me te drejte riperteritje. Emerimi i administratoreve prodhon efekte ndaj pas regjistrimit ne QKB.
- 12.2 *Personi i meposhtem caktohet si Administrator i pare i shoqerise, duke patur te drejta te administrimit te veprimtarise se zakonshme te shoqerise parshikuar nga ligji:*

Z.Sokol Alikaj, i lindur më datë 30 Gusht 1980, në Tiranë , dhe banues në Rr Qemal Stafa, P. 11, Sh.2, Ap 19,Tiranë, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtës i letërnjoftimit ne Nr. 034019870 me nr personal  
Emërimi i tij do të prodhojë efekte pas regjistrimit të shoqërisë në Qendrën Kombëtare të Biznesit

## NENI 13 KOMPETENCAT E ADMINISTRATOREVE

- 13.1 *Administratoret kane te drejte dhe detyrohen te:*
- a) Kryejne te gjitha veprimet e administrimit te vendosura nga asambleja e pergjithshme duke zbatuar politikat tregetare
  - b) Perfaqesojne shoqerine
  - c) Kujdesen per mbajtjen e sakte e te rregullt te dokumentave dhe librave kontabel te shoqerise
  - d) Pergatisin dhe nenshkruajne bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurise se veprimtarise dhe se bashku me propozimet per shperndarjen e fitimeve, i paraqesin keto dokumente perpara Asamblese se Pergjithshme per miratim
  - e) Krijojne nje sistem paralajmerimi ne kohen e duhur per rrethanat, qe kercenojne mbarevajtjen e veprimtarise dhe ekzistencen e shoqerise
  - f) Kryejne regjistrimet dhe dergojne te dhena e detyrueshme te shoqerise, sic parashikohet ne ligjin per Qendren Kombetare te Regjistrimit
  - g) Raportojne para Asamblese se Pergjithshme nepermjet relacioneve mbi zbatimin e politikave tregetare dhe te veprimeve te posacme me rendesi te vecante per veprimatrine e shoqerise
  - h) Kryejne detyra te tjera te parashikuara nga ligji.

Fq. 5

- 13.2 Asambleja e pergjithshme mundet ne cdo moment, te shkarkoje administratorin me shumice te thjeshte te votave. Statuti ose rregullore te tjera nuk mund ta kufizojne ose heqin kete te drejte.

**NENI 14**  
**PERGJEGJESITE E ADMINISTRATORIT**

- 14.1 Administratori eshte pergjegjes individualisht ndaj shoqerise ndaj te treteve, per shkelje te ligjeve, per shkelje te statutit, apo per faje te kryera gjate administrimit te shoqerise. Administratorët te cilet kane kryer veprime ose bere marreveshje te pa aprovuara nga asambleja, jane pergjegjes per demet e sjella shoqerise dhe pergjigjen personalisht ose solidarisht per pasojat.
- 14.2 Nese administratori vepron ne kundërshtim me detyrat dhe shkel standartet profesionale eshte i detyruar ti demshperbleje shoqerise demet qe rrjedhin nga kryerja e shkeljes si dhe ti kaloje shoqerise cdo fitim personal qe ata apo personat e lidhur me ta kane realizuar nga keto veprime te parregulta.

**KREU IV**  
**VITI FINANCIAR –EKSPERTET**  
**NENI 15**  
**VITI FINANCIAR**


- 14.1 Viti financiar i Shoqerise fillon me 1 janar dhe perfundon ne 31 Dhjetor, Perjashtimisht , viti i pare financiar fillon nga data e regjistrimit te shoqerise ne QKB dhe mbyllet me 31 dhjetor.

**NENI 16**  
**EKSPERTET**

- 16.1 Eksperti ka per detyre qe te kontrolloje te gjithe dokumentacionin kontabel te veprimtarise ekonomiko tregetare te shoqerise, dhe ate ne lidhje me kontrollet periodike te ushtruara prej tij, per rastet kur ai eshte ngarkuar dhe ka kryer nje gje te tille i ngarkuar nga ana e ortakeve.
- 16.2 Ne permbushje te kesaj detyre eksperti kontabel i autorizuar pergatit raportin me shkrim per nxjerrjen e rezultatit te bilancit financiar vjetor si dhe per ate per kontrollet periodike te ushtruara.

**KREU V**  
**PRISHJA-RIORGANIZIMI I SHOQERISE**  
**NENI 17**  
**PRISHJA DHE LIKUJDIMI I SHOQERISE**

- 17.1 ***Shoqeria konsiderohet e shperndare kur:***
- a) Kur mbaron kohezgjatja e parashikuar e shoqerise
  - b) Me vendimet e asamblese se Ortakeve
  - c) Me hapjen e procedurave te falimentit
  - d) Nese nuk zhvillon aktivitet tregetar per 2 vjet dhe nuk eshte njoftuar pezullimi i veprimtarise ne perputhje me piken 3 te nenit 43 te ligjit nr. 9723 date 03.05.2007 Per Qendren Kombetare et Regjistrimit,
  - e) Me vendim gjykate.



Fq. 6

**NENI 18**  
**RIORGANIZIMI I SHOQERISE**

- 18.1 Shoqeria mund te ndahet, bashkohet sipas vendimit te Mbledhjes se Pergjithshme te Asamblese se Ortakeve, ne perputhje me dispozitat ligjore te ligjit mbi shoqerite tregtare.

**NENI 19**  
**KLAUZOLA MBI KONFLIKTIN E INTERESIT**


- 19.1 Ortaket dhe administratoret e shoqerise me pergjegjesi te kufizuar, nuk mund te mbajne pozicionin drejtues apo te jete te punesuar ne nje shoqeri qe ushtron aktivitet ne te njejten fushe me te paren
- 19.2 Ndalimi i pikes 19.1 mund te anulohet ne asamblene e pare te pergjithshme me  $\frac{3}{4}$  e votave ne sipas dispozitave te neneve 87 dhe 145 te ligjit per shoqerite tregtare.

**NENI 20**  
**MOSMARRVESHJET**

- 20.1 Per mosmarrveshjet midis ortakeve te shoqerise, ose shoqerise me te tretet, gjykata kompetente per zgjidhjen e tyre do te jete Gjykata Shqiptare.
- 20.2 Ky akt, u redaktua ne 4 ekzemplare ne gjuhen shqipe, me vlere te njejte ligjore, nga te cilat njera ruhet ne arkiven noteriale.

**ORTAKET/THEMELUESIT**

**Renalto Murati**



**Sokol Alikaj**

